



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2896 Prot.

Tiranë, më 12.12.2025

VENDIM

Nr. 374, datë 11.12.2025

**“PËR ZGJEDHJEN E DREJTUESIT TË PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”**

Bazuar në nenet 148/dh, pika 3 dhe 149, pika 1, të Kushtetutës, në nenin 52, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 15, pika 1, të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, 184, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr. 303, datë 19.9.2023, “Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, pasi zhvilloi intervistat me kandidatët për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe votoi njëkohësisht për secilin prej tyre, votim nga i cili rezultoi, se kandidati Adnan Xholi mori 3 vota, kandidati Doloreza Musabelliu mori 0 vota, kandidati Elvin Gokaj mori 1 votë dhe kandidati Klodjan Braho mori 7 vota, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zgjedhjen e prokurorit Klodjan Braho në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Mandati i prokurorit Klodjan Braho në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është 3 (tre) vjet, pa të drejtë rizgjedhje, duke filluar nga data 19.12.2025 deri në datën 19.12.2028.
3. Të njoftohen me këtë vendim Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe prokurori Klodjan Braho.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 11.12.2025.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR

Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla